



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KRUIJË
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

Nr. 3936/Prot
1

Krujë, më 18 / 06 /2021

Lënda: Kthim përgjigje kërkesës tuaj me nr. Prot, 3936 datë 11/06/2021, mbi prioritetet e komunitetit dalë nga pyetëtori.

KËSHILLIT TË BASHKISË KRUIJË

ZNJ.BESA SHETA

Në përgjigje të shkresës tuaj nr 3936 prot., datë 11/06/2021, në lidhje me shkresën për mundësinë e përfshirjes në "Projektin e Parë të Buxhetit Afatmesëm 2022-2024 të Bashkisë Krujë" të prioriteteve të sugjeruara nga komuniteti nëpërmjet pyetëtorit, sqarojmë mbi prioritetet e komunitetit si më poshtë:

Duket qartazi se nga pyetëtori kanë rezultuar prioritetet më kryesore kujdesi për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara, ujitja dhe kullimi si dhe arsimit i mesëm i përgjithshëm nga ku më pas ndiqen nga prioritetet e tjera

1. Sa i përket prioritetit mbi kujdesin për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara janë të përfshira në buxhet dhe janë fonde të sigurta buxhetore. Ndër to përmendim edhe paaftësinë, ndihmën ekonomike dhe së fundmi dhe bonusi i qirasë të cilat janë të përfshira në projekt buxhet me vlerat monetare 396'348 mijë lekë për programin e paaftësisë dhe ndihmës ekonomike dhe 352'425 mijë lekë për bonusin e qirasë.
2. Së dyti, prioritet ka dalë për ujitjen dhe kullimin. Është një funksion i deleguar dhe janë parashikuar fonde dhe në rritje në buxhetin e vitit 2021 për këtë prioritet në vlerën 5'910 mijë lekë duke arritur vlerën prej 21'908 mijë lekë dhe gjithashtu parashikohet në vitin 2022 një vlerë prej 22'408 mijë lekë, në vitin 2023 në vlerën 22'633 mijë lekë dhe në vitin 2024 22'875 mijë lekë. Së treti, në lidhje me prioritetin e arsimit të mesëm, mund të themi se bashkia ka bërë investime në ndërtesat e shkollave por përse i përket funksioneve operative për arsimin e mesëm nuk janë nën varësinë e bashkisë por të institucioneve arsimore.
3. Gjithashtu, theksojmë se prioritet për PBA-në draftin e parë, janë shërbimet publike të cilat zënë peshën më të madhe të buxhetit ku janë parashikuar 250'648 mijë leke për shërbimet

3. Qjithashtu, theksojmë se prioritet për PBA-në draftin e parë, janë shërbimet publike të cilat zënë peshën më të madhe të buxhetit ku janë parashikuar 250'648 mijë leke për shërbimet publike në vitin 2022, dhe 253'315 mijë lekë respektivisht për vitin 2023 dhe vitin 2024. Qjithashtu prioritet është edhe programi i rrjetit rrugor rural I cili për vitin 2021 parashikohet në vlerën prej 245'507 mijë lekë duke përfshirë edhe investimet kapitale, për vitin 2022 parashikohet një vlerë prej 250'949 mijë lekë, për vitin 2023 në vlerën prej 252'896 mijë lekë dhe për vitin 2024 në vlerën 253'315 mijë lekë pra si rezultat i parashikimit të rritjes së investimeve publike në vitet e ardhshme për Bashkinë Krujë.

Faleminderit!

KRYETARI I BASHKISË

ARTUR BUSHI

